



Sh.M.Sh.M

Shoqata e Mjekëve Shqiptarë në Maqedoni
Association of Albanian Medical Doctors in Macedonia

PËRMBLEDHJE E ABSTRAKTEVE

XXII

TAKIM PROFESIONAL MJEKËSOR

27 - 29 Tetor, 2017
Strugë

MENAXHIMI I LËNDIMEVE PERFORUESE TË SYRIT ME RUPTURË TË KORNESË DHE KATARAKTË TRAUMATIKE. PREZENTIM RASTI

G. Mehmeti¹, V. Celeva¹, V. Reçi², H. Duma¹, I. Ismaili¹

¹Klinika Universitare për Sëmundjet e Syve - Shkup

²Spitali i Përgjithshëm – Strugë

Hyrje: Lëndimet perforuese të bulbusit të syrit paraqesin gjendje urgjente në oftalmologji. Lëndimet perforuese ndodhin gjatë lëndimit me mjet të mprehtë ose nga mjet me shpejtësi të madhe të lëvizjes. Këto lloje të lëndimeve mund të sjellin deri te dëmtimi i shikimit, si edhe deri te ftiza e bulbusit ose humbja e tij.

Qëllimi: Prezentimi i lëndimit perforues me rupturë të kornesë dhe kataraktë traumatike.

Prezentim i rastit: Pacient mashkull i moshës 79 vjeçare, i cili është rrëzuar në tokë dhe ka lënduar syrin nga degët e bimës. Në pranim kemi konstatuar mprehtësinë e të parit deri në lëvizje të dorës para syrit, shtypja intraokulare normale në palpim digjital. Biomikroskopimi: kapaku i sipërm lehtë i lëshuar dhe edematoz, aparati lakrimal pa ndryshime patologjike, konjunktiva hiperemike, kornea me rupturë qendrore, me flap (9-3h), edematoze. Dhoma e përparme e cekët, me humbje të lëngut ujqor. Lensi: kataraktë traumatike. Inqizimi radiologjik pa shenja patologjike. Pacientit i është aplikuar mbrojtja antitetanike dhe është trajtuar në dy akte. Fillimisht është bërë toaleta e bulbusit me suturë të kornesë, ndërsa pas 3 muajve është operuar katarakta traumatike dhe është implantuar lens intraokular. Pas ndërhyrjes shikimi është përmirësuar deri në 0,5 cum IOL, kornea me mjegullim të lehtë paracentral (3h), dhoma e përparme, e formuar, pa përmbajtje patologjike. Lensi intraokular mirë i pozicionuar.

Përfundimi: Përpunimi primar në kohë i lëndimeve perforative dhe trajtimi sekondar i kataraktës traumatike sjell deri te evitimi i komplikimeve të cilat mund të sjellin deri në humbje të shikimit si edhe të bulbusit të syrit.

Fjalë kyçe: lëndime perforative, raptura e kornesë, katarakta traumatike